

20111352977

L I G J
PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SHOQATA
DHE FONDACIONE

Neni 1

Në Ligjin për shoqata dhe fondacione ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numer 52/10), pas nenit 43 shtohen dy nene të reja 43-a dhe 43-b, si vijojne:

"Neni 43-a

(1) Nese regjistri nuk e leshon aktvendimin, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kerkeses në afatin e percaktuar në nenin 43 paragrafi (1) të ketij ligji, parashtruesi i kerkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes nga kalimi i ketij afati të paraqese kerkese në sekretarine e personit i cili udheheq organin, për miratimin e aktvendimit nga personi i cili udheheq organin.

(2) Formen dhe permbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri i Drejtesise.

(3) Personi i cili udheheq organin detyrohet që në afat prej pese diteve të punes nga dita e parashtrimit të kerkeses nga paragrafi (1) i ketij neni, ta leshoje aktvendimin.

(4) Me kerkesen për realizimin e së drejtes nga paragrafi (1) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses parashtron kopje të fleteparaqitjes nga neni 43 paragrafi (1) i ketij ligji.

(5) Nese personi i cili udheheq organin nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (3) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

(6) Inspektorati Shteteror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjete ditesh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i ketij neni, të kryeje mbikeqyrje inspektuese në Regjistrin dhe të konstatoje nese procedura eshte zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer, ta njoftoje parashtruesin e kerkeses për gjendjen e konstatuar gjate mbikeqyrjes së kryer.

(7) Inspektori pas mbikeqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon personin i cili udheheq organin që në afat prej dhjete ditesh të vendose për kerkesen e parashtruar, perkatesisht ta pranoje ose refuzoje kerkesen dhe për masat e ndermarra në afatin e njejte ta njoftoje inspektorin dhe t'i dorezoje ekzemplar të aktit me të cilin eshte vendosur për kerkesen.

(8) Nese personi i cili udheheq organin nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i ketij neni, inspektori do të parashtroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të caktoj afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilin personi i cili udheheq organin do të vendose për kerkesen e parashtruar, për cfare në afatin e njejte do ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kerkesen e paraqitur. Inspektori në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(9) Nese personi i cili udheheq organin nuk vendos as në afatin plotesues nga paragrafi (8) i ketij neni, inspektori në afat prej tri diteve të punes do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në kete afat do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(10) Nese inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (6) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses në afat prej pese diteve të punes ka të drejte që të paraqese kundershtrim në sekretarine e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine në seline e Inspektoratit Shteteror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ detyrohet që në afat prej tri diteve të punes nga dita e pranimit, ta shqyrtoje kundershkrimin nga paragrafi (10) i ketij neni dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kerkeses nga paragrafi (6) i ketij neni ose nuk ka paraqitur kallezim në pajtim me paragrafin (9) të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të parashtroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të caktoj afat plotesues prej pese diteve të punes në të cilin inspektori do të kryeje mbikeqyrje në Regjistrin nese procedura eshte zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer, ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(12) Nese inspektori nuk vepron as në afatin plotesues nga paragrafi (11) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizoj inspektor tjetër që ta kryeje mbikeqyrjen menjehere.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ në afat prej tri diteve të punes, do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(15) Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent, në afat prej tete diteve të punes.

(16) Nese personi i cili udheheq organin nuk vendos në afatin nga paragrafi (9) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative eshte urgjente.

(18) Akti nenligjor nga paragrafi (2) i ketij neni do të miratohet në afat prej 30 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

(19) Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi (2) i ketij neni, ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 oresh publikohet në ueb faqen e Ministrise së Drejtesise.

Neni 43-b

Kunder aktvendimit me të cilin refuzohet kerkesa për leshimin e aktvendimit, kerkuesi ka të drejte ankese në afat prej 15 ditesh në Komisionin Shteteror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise", pervec dispozites nga neni 43-b i ketij ligji, e cila do të filloje të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shteteror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.